



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 23.10.2015]

Për: Operatorin ekonomik “Taulant” shpk me NIPT K61617040L

Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për Propozime”** me objekt : **“Mbikqyrje për punime rrugore”**, ndare ne tre lote, per lotin me objekt: **“Mbikqyrje punimesh për sistemimin dhe asfaltimin e rrugës Sanxhak - Superstrade”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Mbikqyrje për punime rrugore”**, ndare ne tre lote, loti me objekt: **“Mbikqyrje punimesh për sistemimin dhe asfaltimin e rrugës Sanxhak - Superstrade”**.
Kohëzgjatja: **4 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Fondi limit: **551.391 (peseqind e pesedhjte e nje mije e treqind e nentedhjte e nje) lekë pa tvsh.**

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 05.10.2015.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Nuk ka patur.

| Njoftojmë se per kete lot kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh: NR | OPERATORI EKONOMIK | OFERTA PA TVSH |
|--|---------------------------|-----------------------|
| 1 | TAULANT | 484.021 |
| 2 | ZENIT 06 | 450.000 |

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtem me arsyet përkatëse:**Shoqeria “Zenit 06” shpk per arsye se:**

Oferta e paraqitur eshte me e ulet se vlera minimale e lejuar e percaktuar ne nenin 7 te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Nuk ploteson piken 2.3.2 te Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit pasi per inxhinierin e ndertimit ing. Rexhep Tarba, ing elektrik Spiro Pleqi dhe per ing. Hidroteknik Leonora Pacili nuk ka paraqitur diplomen. Gjithashtu ing. Leonora Pacili nuk figuron ne listepagesen e kompanise, ndonese kontrata e punes eshte lidhur ne vitin 2012 me afat 10 vjecar.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “Taulant” shpk, me NIPT K61617040L, se oferta e paraqitur, me vlerë 484.021 (katerqind e tetedhjetë e kater mija e njezet e nje) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **15.10.2015.**

Ankesa: Nuk ka patur.

